

VENDIM
Nr. 631, datë 7.9.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RESTAURIMI DHE KTHIMI NË IDENTITET I GODINËS SË PREFEKTURËS SË
QARKUT TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe kthimi në identitet i godinës së Prefekturës së Qarkut Tiranë”.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Prefekturës së Qarkut Tiranë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme 5 521 182 (pesë milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 521 182 (pesë milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Prefekturën e Qarkut Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Prefektura e Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM

Nr .	Zona kadastral e	Nr. i pasurisë	Adres a	Pronari	Sipërfaq e trualli	Sipërfaq e ndërtimi	Çmim i truall	Çmimi i ndërtësës	Vlera e truallit	Vlera e ndërtësës	Vlera truall dhe ndërtësë	Shënime
1	8380	3/170-N4 & 3/170/N D - N3	Tiranë	Arben Haderaj	22.3	22.3	66,969	32,113	1,493,409	716,120	2,209,529	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8380	3/170/N D - N7	Tiranë	Enver Zhubi	0	24.32	66,969	32,113	-	780,988	780,988	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Për truallin saktësim dokumentacioni
3	8380	3/170/N D - N2	Tiranë	Faruk Hyseni	21.6	21.6	66,969	32,113	1,446,530	693,641	2,140,171	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	8380	3/170/N D - N6	Tiranë	Hamdi Çeço	0	12.16	66,969	32,113	-	390,494	390,494	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
				SHUMA							5,521,182	

LISTA E PRONARËVE PËR SHPRONËSIM

Nr .	Zona kadastral e	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaq e trualli	Sipërfaq e ndertimi	Çmimi i truall	Çmimi i ndërtesës	Vlera e truallit	Vlera e ndërtesës	Vlera truall dhe ndërtesë	Shënime
1	8380	3/170-N4 & 3/170/N D - N3	Tiranë	Arben Haderaj	22.3	22.3	66,969	32,113	1,493,409	716,120	2,209,529	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8380	3/170/N D - N7	Tiranë	Enver Zhubi	24.32	24.32	66,969	32,113	1,628,686	780,988	2,409,674	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Për truallin saktësim dokumentacioni
3	8380	3/170/N D - N2	Tiranë	Faruk Hyseni	0	21.6	66,969	32,113	-	693,641	693,641	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	8380	3/170/N D - N6	Tiranë	Hamdi Çeço	0	12.16	66,969	32,113	-	390,494	390,494	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
				SHUMA							5,703,338	